



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 109, datë 29.07.2020

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE
PËRSHKRIMIN E DETYRAVE TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES
FINANCIARE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 10 dhe nenit 20, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e detyrave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Rregullorja nr. 130, datë 31.08.2017 “Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e detyrave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, shfuqizohet.
3. Organizimi, funksionimi dhe përshkrimi i detyrave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në përputhje me këtë rregullore, të bëhet brenda datës 15 shtator 2020.
4. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR
Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE